

Nr. Prot. 030/B/17

VENDIM Nr. 983

**Për
Miratimin
e**

“Rregullores Teknike për Radio - Pajisje”

Në mbështetje të nenit 1, neni 9 paragrafi 3.8, neni 10 paragrafit 4, neni 79, paragrafi 1) dhe 2), dhe neni 94 i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe neni 20 të Rregullores së Brendshme (*Ref. Nr.Prot.161/06*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- | | |
|----------------------|------------------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar i Bordit |
| 2) z. Nijazi Ademja | Anëtar i Bordit |
| 3) z. Hazir Hajdari | Anëtar i Bordit |
| 4) z. Bahri Anadolli | Anëtar i Bordit |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar i Bordit |

në mbledhjen e 16-të me radhë të mbajtur më datë 19 Shkurt 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DRMI, DKE dhe DL, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet **“Rregullorja Teknike për Radio - Pajisje”**.
- II. Rregullorja Teknike për Radio – Pajisje do të fillojë të zbatohet me datë 31 Dhjetor 2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 94 i Ligjit përcakton se *“Kushtet dhe kërkesat themelore për lidhje të radio-pajisjeve dhe pajisjeve terminale telekomunikuese, obligimet që kanë të bëjnë me informatat për specifikat e ndërfaqeve dhe lidhjen me radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, procedurat dhe kushtet për dalje në treg, shitje*

dhe përdorim të këtyre pajisjeve, procedurat dhe kushtet për testim të konformitetit, aprovimi dhe monitorimi, si dhe kërkesat përgjegjëse duhet të përshkruhen në Rregulloren Teknike për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese, të aprovuar nga Autoriteti.”

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit.

Prishtinë, 27/04/2017

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

**Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

Aktvendimi i dërgohet:

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë;
- Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë
- Departamentit të Radio Monitorimit dhe Inspektimit, ARKEP;
- Arkivit, ARKEP